

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PAJISJEVE DHE INSTALIMEVE ELEKTRIKE

UDHEZIM

MBI KRITERET E PRANIMIT DHE MIRATIMIT TË PROJEKTEVE ELEKTRIKE
NGA D.I.P.I.E

Në zbatim të Ligjit Nr. 8734 dt.01.02.2001 (i ndryshuar) për projektet elektrike që do të paraqiten për miratim pranë I.Q.T do të zbatohet procedura si më poshtë :

Dokumentacioni që kërkohet të paraqitet pranë I.Q.T-së duhet të jetë i sistemuar në dosje, e cila duhet të përmbajë :

I. Përmbajtja e dosjes.

- 1) Kërkese zyrtare drejtuar kryeinspektorit të I.Q.T për shërbimin që kërkohet (e miratimit të projektit elektrik) e cila duhet të përmbajë të dhënat kryesore të projektit, piken e kontaktit, materialet që paraqiten bashke me projektin, datën e paraqitjes etj.
- 2) Formularin shoqërues të deklaratimit, për projektin elektrik të plotësuar me të dhënat për subjektin, objektin dhe për cdo të dhënë që kërkohet në formular(sipas modelit bashkëngjitur).
- 3) Dy ekzemplare të projektit elektrik, një nga të cilat të jetë origjinale tjetra detyrimisht fotokopje e noterizuar.
- 4) Licensa e projektuesit elektrik fotokopje e noterizuar.
- 5) Ekstrakt të Regjistrisë Tregtare për të Dhënat e Subjektit, (ekstrakti QKR) i shoqërisë që do të kryej projektin elektrik ose kontratën e ing. elektrik projektues me shoqërinë .
- 6) Për objektet e reja :
 - Lidhja e objektit me infrastrukturen inxhinierike.
 - Leja e ndertimit.
 - Leja e sheshit të ndertimit me plan vendosjen (formulari 2) të miratuara nga KRRT (fotokopje të noterizuara).
- 6/1) Për objektet egzistuese që kryhet rikonstruksion instalimesh ose shtese fuqie: Fotokopje e noterizuar e hipotekimit të objektit.
- 6/2) Në rast se objekti është marrë me qira:
 - Akt-Marveshja noteriale me pronarin ligjor të objektit ku të cilesohet e drejta për rikonstruksione instalimesh.
- 7) Në rast se për furnizim me energji elektrike të objektit ka kabine elektrike murature ;
 - jashtë objektit, ajo duhet të jetë e specifikuar të leja e ndertimit dhe të sheshi i ndertimit (nga KRRT).

- brenda objektit duhet te paraqitet ajo ne plan vendosjen e katit perdhe (nuk pranohet ne kuota nen nivelin e tokes dhe ne mjedise me rrezik zjarri, prezence ujrash, e me rruge veshtiresisht te kalueshme).
 - Ne Gen-Plan kabina të paraqitet me dimensionet e saj dhe ne raport me mjediset e tjera ne kat e konfirmuar nga arkitekti. Po ashtu dhe cdo planimetri kati me mobilimin perkates, te jete e konfirmuar nga arkitekti.
- 8) Akt-Marveshje me pronarin ligjor te tokes, per shfrytezimin e trasese se linjes, kontrate qiraje etj (ne se ka projekt linje elektrike) .
- 9) Lista e dokumentave qe permban dosja.

Kjo dosje dorezohet ne zyren e Protokollit te institucionit.

Nenvizojme: Institucioni nuk mer ne shqyrtim projekte elektrike per objektet qe jane te pa ligjeshme.

FORMULAR SHOQËRUES DEKLARIMI
I KËRKESËS PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT ELEKTRIK NË I.Q.T

Dt. ___/___/___

Nr.	Emërtimi i kërkesave.	Plotësohet nga subjekti që paraqet projektin.					
I	Të dhëna për subjektin:						
1.	Emërtimi i subjektit që paraqet projektin elektrik.						
2.	Emri i presidentit, pronarit, përfaqesuesit ligjor.						
3.	Numuri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT)						
4.	Adresa e plotë e selisë së subjektit.						
5.	Nr.Tel.të subjektit.						
II	Të dhëna për projektuesin :						
1.	Emri dhe mbiemri i projektuesit elektrik.						
2.	Nr. i liçensës së projektuesit elektrik.						
3.	Nr. tel i projektuesit elektrik.						
III	Të dhëna për projektin :						
1.	Emërtimi i plotë i projektit elektrik.						
2.	Vendndodhja e objektit.						
3.	Fuqia e instaluar, e kërkuar, e pikut, cos Ø, fuqia e elektromotorit më të madh.	P_{inst} KW	P_k KW	P_{Pik} KW	Cos Ø	S_{tr} KVA	$P_{el\ max}$ KW
4.	Numuri dhe lloji i fletëve të projektit.						

Përfaqesuesi i subjektit ose projektuesi.
(_____)